

VENDIM
Nr.825, datë 26.11.2014

**PËRHEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES DHE VOLUMIT TË
EKONOMIVE PYJORE “KASTRIOT SLOVË” DHE “DESHAT MAQELLARË”,
DIBËR, QË DO TË PËRDOREN NGA SHOQËRIA “HEIDORN & BINJAKU”
SHPK, PËR SHFRYTËZIMINE MINERALIT TË GIPS ALABASTERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 94.8 ha, në ngastrat nr. 238/b, 238/c, 238/d, 239/c, 239/d e 239/e, të ekonomisë pyjore “Kastriot Slovë” dhe ngastra nr. 1a, e ekonomisë pyjore “Deshat Maqellarë”, në objektin “Vrejt Radomirë”, Dibër, që do të përdoret nga shoqëria “Heidorn & Binjaku” sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit të gips alabasterit, të hiqet nga fondi pyjor publik dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Të dhënat për ngastrat pyjore jepen në lidhjen nr. 1 dhe hartën topografike bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të sipërfaqes së hequr dhe të volumit të lëndës drusore paguhen nga shoqëria “Heidorn & Binjaku” sh.p.k., në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Heidorn & Binjaku” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në përdorim, sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda 2 viteve të para, të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe prej 6.8 ha fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit.

4. Ministria e Mjedisit dhe shoqëria “Heidorn & Binjaku” sh.p.k. të nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët për hapat, afatet dhe procedurat për hartimin e projekteve teknike lidhur me detyrimet, sipas pikës 3, të këtij vendimi.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

6. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të bëjë çregjistrimin e sipërfaqes pyjore, të identifikuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore/kullosoret etj” dhe ta regjistrojë atë në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit, sipas lejes mjedisore, nga shoqëria “Heidorn & Binjaku” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet fond pyjor publik.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe shoqëria “Heidorn & Binjaku” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E NGA STRAVE QE HIQEN NGA FONDI PYJOR PER
KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR NGA SHOQERIA
HEIDORN&BINJAKU shpk ne qarkun DIBER

Lidhja 1

<i>ID e prones</i>	<i>ekonomia pyjore/ kullosore</i>	<i>nr. i ngastres</i>	<i>Administrimi</i>	<i>siperfaqja HA</i>
DI18	Deshat-Maqellare	1a	Ministria Mjedisit	27.1
DI21	Kastriot Sllove	238a	Ministria Mjedisit	6.5
DI21	Kastriot Sllove	238b	Ministria Mjedisit	0.3
DI21	Kastriot Sllove	238c	Ministria Mjedisit	1.5
DI21	Kastriot Sllove	238d	Ministria Mjedisit	13.5
DI21	Kastriot Sllove	239c	Ministria Mjedisit	28.9
DI21	Kastriot Sllove	239d	Ministria Mjedisit	1.1
DI21	Kastriot Sllove	239e	Ministria Mjedisit	15.9
	GJITHSEJ			94.8



Shpjegues

Kufi zone te mbrojtur

Zone e kerkuar (0.94 km²)

Kufi parcele

Kufi nenparcele

EP	nenparcele	sip (m2)
Deshat Manellare	1a	270366
Kastriot Silove	238a	66207
Kastriot Silove	238b	2861
Kastriot Silove	238c	19886
Kastriot Silove	238d	134552
Kastriot Silove	238e	288901
Kastriot Silove	239a	10512
Kastriot Silove	239b	159315
Kastriot Silove	239c	947710
Totale		

nr	x	y
1	4453300	4622200
2	4453370	4623000
3	4453000	4625000
4	4453450	4625000
5	4453850	4623000
6	4454500	4622400
7	4453760	4622000
8	4453417	4623815
9	4453232	4623649

Shkalla 1:10000

0 0.45

4453000

4455000

445000

4453000

4455000

44570

